



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6072 Prot.

Lezhë, më 06 . 04 . 2021

VENDIM

Nr. 62 Datë 30 . 03 . 2021

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmes financiare për dëmin e shkaktuar nga permbytja të banesës së shtetasit Marjan Ndreke Margegaj , banor në fshatin Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhenies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Marjan Ndreke Margegaj, banor në fshatin Dajç, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Marjan Ndreke Margegaj për dëmtimin e banesës së tij nga permbytja.

A. Të miratojë demin e shkaktuar nga permbytja në vlerën 123500 lekë.

a) Demi i shkaktuar në ndertese 0 lekë.

b) Demi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje 123500 lekë.

B. Mbështetur ne VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, germat b e ç, Kompensimi per demin e shkaktuar ne anen ndertimore te jete ne masen 50%, ndersa Kompensimi per demin e shkaktuar ne orendi, mobilje e pajisje, mbeshtetur ne kap 3, pika 3 germa d, te VKM-së së mesiperme te jete sa masa e demit te shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e Kompensimit të demit në anen ndertimore të jetë 0 lekë.

b) Vlera e Kompensimit të demit në orendi, mobilje e pajisje 123500 lekë.

Vlera totale 123500 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhë t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Marjan Ndreke Margegaj me Nr.ID. H40317035F ndihmen emergjente në vlerën prej 123500 (njqind e njezet e tre mije e peseqind)

lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2021, bazuar ne VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndihma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihme familjes së shtetasit Z.Marjan Ndreke Margegaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga permbytja.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

